



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**



KCSF

FONDACIONI KOSOVAR PER SHOQERË CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË TRANSPARENCËS DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA

PRILL 2023

PRILL 2023

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesë vjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**



FONDACIONE KOSOVARE PER SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË TRANSPARENCËS DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË KOMUNA

Ky raport është bërë i mundur nga mbështetja bujare e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbajtja:

1. Hyrja	3
2. Përshkrimi i përgjithshëm	4
3. Mjetet e Monitorimit të Konsultimeve Publike në Komuna	5
3.1. Instrumenti për monitorimin e proceseve individuale të konsultimeve	5
4. Instrumentet e Monitorimit dhe Raportimit Vjetorë të Zbatimit të Konsultimit Publik në Komuna ...	5
5. Procesi i Konsultimit Publik në Komuna	6
5.1. Instrumenti për vlerësimet vjetore.....	10
5.2. Sqarime/Informata teknike.....	14

1. Hyrja

Në nivelin komunal, proceset konsultative mbeten të paqarta e me angazhim të kufizuar të qytetarëve. Kjo, si rrjedhojë e një procesi të papërgatitur mirë, si dhe një zbatim kryesisht formal nga ana e institucioneve komunale. Ajo që mbetet më sfiduese është ndër-veprimi mes komunave dhe qytetarëve. Në mungesë të një qasje të vazhdueshme të informimit dhe komunikimit nga komunat, qytetarët nuk po arrijnë të ndjekin se si çështjet e tyre po adresohen në politikat dhe financimet komunale. Në këtë mes edhe roli i shoqërisë civile dhe profesionistëve, mbetet i pa përfshirë në kontributin për politikat komunale. Procesi i monitorimit përdor një qasje dy kahore të intervenimit: në njërin anë, vlerëson nivelin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në nivelin lokal, e në anën tjetër, ofron informacione nëpërmjet të dhënave, konkluzioneve dhe rekomandimeve si mjete për përmirësim.

Duke u bazuar në metodologjinë e suksesshme ekzistuese të monitorimit mbi konsultimet publike në nivel kombëtar, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Instituti i Qeverisjes Lokale të Kosovës (KLGJ) kanë zhvilluar një metodologji monitorimi të përshtatur që synon të monitorojë dhe raportojë për gjithë përfshirjen dhe transparencën e vendimmarrjes në nivel lokal. Metodologjia e monitorimit do të jetë e qasshme dhe e lehtë për t'u përdorur nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) lokale pa ekspertizë në monitorim, si dhe nga iniciativat qytetare dhe qytetarët e interesuar në aktivizmin vëzhgues të bazuar në fakte. Kjo metodologji është zhvilluar në kuadër të Programit për Angazhim Qytetar (CEA), i cili program përkrahë aktivitete të shumta të cilat synojnë përmirësimin e lidhjes së shoqërisë civile me qytetarë, bashkëpunimin brenda sektorit dhe me sektorë të tjerë, si dhe diversifikimin e burimeve të shoqërisë civile përtej fondeve të donatorëve të huaj me qëllim të fuqizimit të pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies të institucioneve publike dhe të OShC-ve ndaj publikut.

Programi për Angazhim Qytetar në Kosovë është një iniciativë pesëvjeçare zbatuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). KLGJ-ja është partner i KCSF-së në realizimin e këtij aktiviteti. Bazuar në përvojën e gjatë dhe ekspertizën e KCSF-së në zhvillimin e shoqërisë civile, duke përfshirë qasje të reja që kanë për qëllim ndërlidhjen e organizatave të shoqërisë civile me qytetarë dhe qytetare të Kosovës, dhe në bashkëpunim me organizata vendore dhe ndërkombëtare, CEA do të kontribuojë drejt arritjes së objektivave në vijim:

Objektiva 1: Fuqizimi i bashkëpunimit të shoqërisë civile me qytetarë dhe qytetare të Kosovës, nxitja e aktivizimit komunitar dhe rritja e kërkesës për llogaridhënie.

Objektiva 2: Krijimi i partneriteteve brenda dhe ndërmjet sektorëve dhe rritja e besimit mes OShC-ve, qytetarëve, sektorit privat dhe institucioneve publike.

Objektiva 3: OShC me njohuri e aftësi të shtuara që e shfrytëzojnë kuadrin e përmirësuar ligjor dhe zhvillojnë kulturën e përkrahjes së aktiviteteve jo për përfitim nga burimet vendore dhe të diasporës.

2. Përshkrimi i përgjithshëm

Ky dokument ka për qëllim të shpjegojë/përshkruajë logjikën e procesit të Monitorimit të Konsultimit Publik në Nivelin Lokal, referuar Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komunë (MAPL-04/2023-UA)¹, si dhe Doracakut për Konsultim Publik në Komuna², hartuar nga Ministria përgjegjëse për Pushtetin Lokal.

Metodologjia është ekstraktimi i treguesve të monitorimit të organizuara në kategori nga dispozitat e parashikuara në Udhëzimin Administrativ, si dhe sqarimet/interpretimet në Doracak. Kategoritë grupojnë fusha të caktuara të ndërlidhura në formë logjike, të ndara në nën-kategori. Në tri kategori, ndërtohen shtyllat e procesit, ndërkaq treguesit e veçantë, në varësi të nevojave të mund të shtohen/ndryshohen.

Kategoritë dhe procesit të konsultimit ndahen në tri faza:

Faza e parë,

- Planifikimi i konsultimeve publike;

Faza e dytë,

- Shpallja e thirrjes;
- Mbajtja e konsultimeve publike;
- Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre në organet përgjegjëse;

Faza e tretë,

- Mbikëqyrja, raportimit dhe monitorimi i zbatimit.

Metodologjia nëpërmjet treguesve ofron proces të strukturuar, duke vlerësuar kategoritë veç e veç dhe në tërësi procesin. Në nën-kategori, reflektohen disa aspekte kryesore **procesi i konsultimit publik në komuna**.

Planifikimi i konsultimeve publike (*Caktimi i Zyrtarit/ve përgjegjës për konsultim; Planifikimi i konsultimeve publike; Përfshirja e konsultimeve në planin e punës së komunës; Përfshirja e konsultimeve në planin e komunikimit; Plani i veçantë i zyrtarit për konsultime; Publikimi i planeve dhe raporteve të konsultimeve në ueb faqe dhe platformën e konsultimeve publike*).

Mbajtja dhe procesi i konsultimeve publike (*Hapja e konsultimit publik dhe publikimi i dokumenteve për konsultim; njoftimi/identifikimi i palëve të interesuara dhe përfshirja në grupet punuese nga zyrtari përgjegjës për konsultim; Mbajtja e së paku një takimi konsultativ; Vendosija e adresës fizike dhe elektronike ku mund të adresohen komentet; Zhvillimi i konsultimit publik nga iniciuesi, përfshirë edhe propozimet nga grupet e jashtme; Udhëhiqja e procesit të konsultimit nga sektori/drejtorja në kompetencë e së cilës është fusha e propozuar e politikës; publikimi i afatit të konsultimit dhe personit përgjegjës për konsultim*).

Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi (*Njoftimi për takime publike, vënien në diskutim me anëtarët e grupit, shqyrtimi i komenteve nga kryesuesi apo udhëheqësi i grupit të punës; Publikimi i dokumenteve në ueb-faqe dhe platformën e konsultimeve publike*).

¹ <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84864>

² [FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet-1.pdf \(rks.gov.net\)](#)

Mbikëqyrja, raportimit dhe monitorimi i zbatimit (*Publikimi i përgjigjeve në raportet e konsultimeve; Vlerësimi i Kryetarit të Komunës, nëse aktet që shkojnë për miratim kanë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik; Shqyrtimi nga Kuvendi Komunal, si dhe refuzimi i akteve që nuk përmbushin standardet minimale të konsultimit publik; Raportimi i komunës për procesin e konsultimit në Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; Monitorimi i zbatimit përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale).*

Metodologjia përmban tri lloje të treguesve të thjeshtë me nën-kategori dhe sqarues (lloji i dokumentit/afatet) si dhe ndërlidhjen mes tyre, që vlerësojnë nivelin e zbatimit të procesit të konsultimit nga komunat përkatëse.

Treguesit kryesorë vlerësojnë zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik në komuna, nga Udhëzimi Administrativ dhe Doracaku, një numër i treguesve, pasqyrojnë rezultatet në praktikën që tejkalojnë këtë prag të arritjeve. Monitorimi zbatohet në dy rrafshë: i. Monitorimi (vjetor) i Planifikimit, Mbikëqyrjes dhe Raportimit si dhe Monitorimet (individuale) të Zhvillimit të Konsultimeve Publike, Mbledhjes, Komunikimit dhe Adresimit të Komenteve. Një seksion shtesë ka të bëjë edhe me krahasimin e monitorimeve me të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit të performancës.

3. Mjetet e Monitorimit të Konsultimeve Publike në Komuna

Mjetet e monitorimit, nëpërmjet treguesve matës të Konsultimit Publik në Komuna, ua mundësojnë palëve (institucioneve dhe organizatave monitoruese), qasje pro-aktive dhe komunikim dy-kahorë. Në veçanti në dy (2) dimensione:

- Organizata/Organizatave nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm dhe uniform të konsultimit publik dhe raporteve vjetore, ofrojnë pasqyrim të strukturuar të procesit;
- Komunat identifikojnë mangësitë përgjatë dhe të procesit të tërësishëm të konsultimit publik.

3.1. Instrumenti për Monitorimin e Proceseve Individuale të Konsultimeve

Ky instrument u shërben individëve/organizatave që monitorojnë proceset e veçanta të konsultimit publik në komuna, qoftë nëpërmjet ueb faqeve përkatëse komunale ([Komunat e Kosovës – Republika e Kosovës \(rks-gov.net\)](http://komunat.e.kosoves-republika.e.kosoves.rks-gov.net)), Platformës elektronike/on-line (<http://konsultimet.rksgov.net/>), vlerësimeve nga pjesëmarrja direkte apo intervistave me zyrtarët përkatës. Individëve/organizatave monitoruese, u rekomandohet të regjistrohen në Platformën e Konsultimeve Publike, në mënyrë që të ndjekin direkt edhe procesin e përdorimit të platformës dhe të përfshihen në proceset konsultuese.

4. Instrumentet e Monitorimit dhe Raportimit Vjetor të Zbatimit të Konsultimit Publik në Komuna

Monitorimi i Raporteve Vjetore të Zbatimit të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe hartëzimi u ofron palëve, një pasqyrim të gjerë për hallkat e dobëta të procesit dhe mundësi për raportime të përmbledhura. Dhe mund të shërbejë për të adresuar, në veçanti tri (3) elemente:

- i. Nivelin e përgatitjes teknike dhe procedurale për procesin e konsultimit publik;
- ii. Nivelin e zbatimit të konsultimit publik, duke përfshirë edhe indikatorë cilësorë; si dhe
- iii. Pasqyrimi i nevojave për intervenim, në hallka të veçanta të procesit.

5. Procesi i Konsultimit Publik në Komuna

Në këtë kategori përfshihen gjashtë (6) tregues kryesorë tre (3) të thjeshtë dhe tre (3) kanë nën-tregues me opsionet PO/JO. Në një (1) rast, tek afati i konsultimit kërkohet shënimi i datës së fillimit të konsultimit dhe afati i mbarimit. Treguesit tjerë janë të thjeshtë, të renditur kronologjikisht sipas rrjedhës së procesit të konsultimit publik.

Komuna:				
Emri i projekt aktit për konsultim publik				
Procesi i Konsultimit Publik në Komuna		Opsionet e vlerësimit	Burimi	Ndërlidhja me U/A
1.1	A përfshihet dokumenti në pjesën e akteve obligative ³ për konsultim publik ⁴ ?	PO/JO	Ueb faqja e komunës; Platforma për Konsultime Publike; Pjesëmarrja Aktive; Pyetësori.	Neni 22; 1 (1.1-1.7) dhe 2
1.2	Mbajtja e Konsultimeve Publike <i>A është zbatuar procesi i konsultimit publik para miratimit të projekt propozimit?</i>	PO/JO	Ueb faqja e komunës; Platforma për Konsultime Publike; Pyetësori.	Neni 23; (1)
1.3	A është bërë shpallja e njoftimeve, për konsultim të projekt propozimeve, në platformën e qeverisë për konsultime publike?	PO/JO	Platforma për Konsultime Publike;	Neni 27; (4)
	A është bërë shpallja e njoftimeve për konsultim të projekt propozimeve, në ueb faqen e Komunës me këto të dhëna:	PO/JO	Ueb faqja e komunës;	Neni 27; (4)
1.3.1.	A është publikuar projekt propozimi për të cilin kërkohen komentet?	PO/JO		Neni 27; (3) 3.1

³ 1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë: 1.1 Draft-Statuti i Komunës; 1.2. Projekt-rregulloret Komunale; 1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektoriale; 1.4 Projekt buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor; 1.5.Korniza afatmesme buxhetore për 3 vitet e ardhshme; 1.6.Strategjitë zhvillimore dhe planet e veprimit në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale; 1.7.Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjisllacionit për planifikim hapësinor. 2.Varësisht nga nevojat komuna mund të vendosë në konsultim publik edhe dokumente dhe procese të tjera që zhvillohen në kuadër të kompetencave të komunës, apo politikat e parapara me legjisllacionin në fuqi.

⁴ Gjatë monitorimit mund të përpilohet një listë më e ngushtë se cilat prej dokumenteve të politikave lokale dhe akteve nënligjore të Komunës që janë më me interes për t'u monitoruar;

1.3.2.	<i>A është paraqitur adresa për pranimin e komenteve dhe publikimin e raporteve/rezultateve të konsultimit publik?</i>	PO/JO		Neni 27; (3) 3.2
1.3.3.	<i>A janë paraqitur informatat (emri, mbiemri, e-maili) për personin përgjegjës për pranimin e komenteve?</i>	PO/JO		Neni 27; (3) 3.3
1.3.4.	<i>A është paraqitur adresa ku palët mund të adresojnë shkresat fizike?</i>	PO/JO		Neni 26; (1)
1.3.5.	<i>Afati i fundit për dorëzimin e komenteve;</i>	PO/JO		Neni 27; (3) 3.4
1.3.6.	<i>Data e nisjes;</i>	DD/MM/VV		<i>Neni 28 (1)⁵</i>
	<i>Afati i fundit për komente;</i>	DD/MM/VV		
1.3.7.	<i>A janë publikuar memorandumet shpjeguese të projekt propozimeve për konsultim publik në një rubrikë të veçantë?</i>	PO/JO		Neni 27; (4)
1.3.8.	<i>A ka pasur shtyrje të afatit për procesin e konsultimit?</i>	PO/JO		Neni 28; (2)
1.4	A janë identifikuar palët e interesuara për përfshirje në konsultim publik?	PO/JO	<i>Ueb faqja e komunës; Pyetësori;</i>	Neni 25
1.4.1.	<i>A është bërë thirrje publike nga organi propozues për përfshirjen e përfaqësuesve të grupeve të interesit në grupin punues?</i>	PO/JO		Neni 25; (4)
1.4.2.	<i>A janë identifikuar qytetarët apo palët e interesuara për projekt propozime?</i>	PO/JO		Neni 25; (1)
1.4.3.	<i>A janë përfshirë palët e interesuara në grupet punuese për hartimin e projekt-propozimit?</i>	PO/JO		Neni 25; (3)
1.5	A janë zhvilluar takime publike konsultative?⁶	PO/JO	<i>Ueb faqja e komunës; Platforma për Konsultime Publike; Pjesëmarrja Aktive; Pyetësori;</i>	Neni 16

⁵ Kjo fushë vlerëson nëse konsultimi publik është mbajtur sipas afateve jo më pakë se 15 ditë kalendarike dhe jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e shpalljes;

⁶ Takime me qytetarët, grupet e interesit, shoqëria civile, komitetet konsultative, këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane;

	<i>A është shpallur (në ueb-faqe zyrtare të komunës, tabelën e shpalljeve, etj)?</i>	PO/JO		Neni 16 (2)
1.5.1.	<i>A është shpallur njoftimi për takim publik konsultativ së paku 8 ditë kalendarike para mbajtjes së takimit?</i>	PO/JO		Neni 23 (7)
1.5.2.	<i>A i përmban ftesa për takim publik informacionet e mëposhtme?</i>			Neni 16 (3)
	<i>Data e mbajtjes së takimit;</i>	PO/JO		
	<i>Vendi i mbajtjes së takimit;</i>	PO/JO		
	<i>Koha e mbajtjes së takimit;</i>	PO/JO		
	<i>Projekt propozimin;</i>	PO/JO		
	<i>Memorandumi shpjegues;</i>	PO/JO		
	<i>Informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve);</i>	PO/JO		
1.5.3.	<i>A e ka kryesuar takimin konsultativ me qytetarë, zyrtari për hartimin e projekt propozimit i caktuar nga organi propozues?</i>	PO/JO		Neni 16 (6)
1.5.4.	<i>A e kanë shpjeguar përmbajtjen e projekt propozimit para publikut, zyrtari për hartimin e projekt propozimit së bashku me zyrtarin për konsultim publik?</i>	PO/JO		Neni 16 (6)
1.5.5.	<i>A i kanë evidentuar, propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, zyrtari për hartimin e projekt propozimit së bashku me zyrtarin për konsultim publik?</i>	PO/JO		Neni 16 (6)
1.6	Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre:	Shëno cilat pika janë zbatuar:	<i>Ueb faqja e komunës; Platforma për Konsultime Publike; Pjesëmarrja Aktive; Pyetësori;</i>	Neni 30
1.6.1.	<i>A është përgatitur raporti për rezultatet e Konsultimit Publik nga Zyrtari përgjegjës për hartimin e projekt propozimit?</i>	PO/JO		Neni 30 (1)

1.6.2.	<i>A janë përfshirë në raportin e shqyrtimit publik propozimet, sugjerimet vërejtjet nga publiku?</i>	PO/JO		Neni 30 (2)
1.6.3.	<i>A janë shqyrtuar të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet nga publiku dhe statusi i tyre?</i>	PO/JO		Neni 30 (3)
1.6.4.	<i>A është përgatitur raporti brenda afateve të përcaktuara (jo më shumë se 30 ditë kalendarike që nga përfundimi i afatit për komente)?</i>	PO/JO		Neni 30 (4)
1.6.5.	<i>A është publikuar në ueb faqe dhe platformën e konsultimeve raporti 5 ditë kalendarike nga data e përfundimit të raportit?</i>	PO/JO		Neni 30 (5)

5.1. Instrumenti për vlerësimet vjetore

Ky instrument mundëson një vlerësim gjithëpërfshirës të zbatimit të dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Konsultim Publik në Komuna nga ana komunave në tri aspekte (përgatitjen administrative/teknik; nivelin e planifikimit si dhe nivelin e mbikëqyrjes, bashkëpunimit dhe raportimit). Përveç monitorimit të performancës vjetore, gjithashtu merr parasysh edhe kapacitetet e tyre për ta zbatuar këtë. Në nivel të përgjithshëm, ky instrument përbëhet prej gjithsej shtatë (7) tregues kryesorë, pesë (5) tregues kanë një e më shumë nënë tregues dhe në dy (2) ka vetëm treguesin kryesorë.

Treguesit vjetorë që i shtohen procesit të monitorimit individual të konsultimit publik në komuna, lidhen me:

- Përbushjen e obligimeve administrative; *(caktimi i zyrtarit përgjegjës për konsultim; kategoria e veçantë për konsultime në ueb faqe);*
- Planifikimin e proceseve të konsultimit *(planit vjetore të dokumenteve për konsultim; plani i konsultimeve nga zyrtari përgjegjës; zhvillimi i konsultimit në fazat e hershme me palët e interesuara; përfshirja e palëve të interesuara në grupet punuese);*
- Përbushjen e obligimeve të mbikëqyrjes, koordinimit dhe bashkëpunimit *(ngritja e kapaciteteve nga Ministria përkatëse për pushtet lokal, për zyrtarët përgjegjës; monitorimi i zbatimit nga Ministria; dhe raportimi vjetor te Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit).*

Njëkohësisht, ky monitorim përfshinë pikët vlerësuese, për secilën kategori si dhe për mekanizmat përgjegjës bazuar në Udhëzimin Administrativ për Konsultim Publik në Komuna si:

- Zyrtari përgjegjës për projekt-propozimet;
- Zyrtari për konsultim publik;
- Kryetari i Komunës (përfshirë drejtoritë/zyrat sponsorizuese);
- Kuvendi Komunal; dhe
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndërlidhur me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit;

Në varësi të detyrave, pikët vlerësuese shpërndahen për këta mekanizma, ku në total ndarja është:

Nr	Mekanizmi Institucional	Numri i detyrave të përbushura
1	Zyrtari përgjegjës për projekt propozimet	2
2	Zyrtari për konsultim publik;	6
3	Kryetari i Komunës (përfshirë drejtoritë/zyrat sponsorizuese)	6
4	Kuvendi Komunal	1
5	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndërlidhur me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit;	2

1	Aspekti Administrativ i Konsultimit Publik në Komuna	Opsionet e Vlerësimit	Vendos X nëse është përmbushur nga mekanizmat përgjegjës					Burimi i informacionit	Neni i UA
			Zyrtari përgjegjës për projekt propozimin;	Zyrtari për Konsultim Publik;	Kryetari/spo nsorizuesi	Kuvendi Komunal	MAPL/ZQM		
1.1	Detyra dhe përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për konsultim publik;								
1.1.1	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për konsultim publik;	PO/JO	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Pyetësorët për org. komunale	Neni 24 (2)
1.1.2	Përgatitja e procesit të konsultimeve publike (afatet, kostot financiare, resurset njerëzore, identifikimi i palëve të interesit; format dhe teknikat e konsultimit);	PO/JO	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Plani i Konsultimeve Publike; Plani i veçantë i konsultimeve;	Neni 20 (4)
1.1.4	Përgatitja e raporteve vjetore të konsultimit dhe raportimi te kryetari;	PO/JO	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Pyetësorët për org. komunale	Neni 24 (4)
1.2	Rubrika për konsultimet me shkrim dhe elektronike;								Neni 27; 3 (3.5)
1.2.1	Komuna obligohet të krijoj menu/rubrikë të veçantë brenda ueb faqes zyrtare për procesin e konsultimit publik.	PO/JO	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Ueb faqja;	Neni 27; 3 (3.5)

2	Procesi i Konsultimit Publik në Komuna	Opsionet e Vlerësimit	Vendos X nëse është përmbushur nga mekanizmat përgjegjës					Burimi i informacionit	Neni i UA
			Zyrtari përgjegjës për projekt propozimin	Zyrtari për Konsultim Publik;	Kryetari/spo nsorizuesi	Kuvendi Komunal	MAPL/ZQM		
2.1	Planifikimi i konsultimeve publike;								Neni 12
2.1.1	A është përfshirë planifikimi i konsultimeve publike në planin e punës së Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik?	PO/JO	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	<i>Ueb faqja; Pyetësorët;</i>	<i>Neni 20 (1)</i>
2.1.2	A është përfshirë planifikimi i konsultimeve publike në hartimin e planit për komunikim publik?	PO/JO	Nuk aplikohet	X	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	<i>Ueb faqja; Pyetësorët;</i>	<i>Neni 20 (1)</i>
2.1.3	A ka hartuar zyrtari përgjegjës për konsultim publik plan të veçantë për vitin e ardhshëm kalendarik?	PO/JO	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	<i>Ueb faqja; Pyetësorët;</i>	<i>Neni 20 (2)</i>
2.2	A është krijuar baza e të dhënave me palët e interesuara?	PO/JO	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Pyetësorët;	Neni 25 (2)
2.3	A ka pasur projekt propozime nga grupet e jashtme punuese, iniciativa qytetare, apo komitetet konsultative? ⁷	PO/JO	X	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	<i>Pyetësori</i>	<i>Neni 23 (2)</i>

⁷ Referuar Nenet 70 dhe 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (iniciativat nga grupet e jashtme dhe komitetet konsultative)

3	Procesi i Mbikëqyrjes, Raportimit dhe Monitorimit të Konsultimit Publik në Komuna	Opsionet e vlerësimit	Vendos X nëse është përmbushur nga mekanizmat përgjegjës					Burimi i informacionit	Neni i UA
			Zyrtari përgjegjës për projekt propozimin	Zyrtari për Konsultim Publik	Kryetari/spo nsorizuesi	Kuvendi Komunal	MAPL/ZQM		
3.1	Mbikëqyrja e zbatimit								Neni 32
3.1.1	Kryetari komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik;	PO/JO	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	<i>Monitorimi Individual; Pyetësorët;</i>	<i>Neni 32 (2)</i>
3.1.2	Kuvendi i komunës refuzon aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim administrative;	PO/JO	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	X	Nuk aplikohet	<i>Monitorimi individual; Pyetësorët;</i>	<i>Neni 32 (3)</i>
3.2	Raportimi dhe Monitorimi								Neni 32; 43
3.2.1	Komuna harton raport vjetor të konsultimeve publike dhe e dërgon te Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;	PO/JO	Nuk aplikohet	X	X	Nuk aplikohet	X	<i>Ueb faqja MAPL; Platforma on-line; Pyetësorët;</i>	<i>Neni 32 (2)</i>
3.2.2.	Monitorimi i udhëzimit nëpërmes raportit të performancës komunale;	PO/JO	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	X	<i>Raporti i performancës;</i>	<i>Neni 43 (3)</i>

5.2. Sqarime/Informata teknike

Modeli i vlerësimit shërben për të pasqyruar në një qasje të unifikuar, monitorimin individual dhe atë vjetorë të konsultimeve publike në komuna. Pikët maksimale mundësojnë analizimin dhe krahasimin brenda mekanizmave institucionalë dhe ndërmjet komunave në rezultatet e arritura në procesin e konsultimit publik.

Të dhënat e gjeneruara janë lehtë të kuptueshme dhe me paraqitje të strukturuar në tabela. Ndarja në kategori na mundëson të ndjekim procesin nga aspektet teknike, procesi i konsultimit, mbikëqyrja dhe deri te vlerësimi vjetor dhe raportimi.

Aneks do të shërbehen:

- Formularët e programit Excel për futjen e të dhënave;
 - Monitorimi individual; dhe
 - Vlerësimi vjetor;

Procesi është konstruktuar bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, si i tillë është i gjallë (plotësohet/ndryshohet), në varësi të adaptimit për monitorim, por edhe ndryshimeve në strukturën administrative apo ligjore.

Pyetësorët për mekanizmat institucionalë

Një shtojcë plotësuese do të jenë model-pyetësorët për mekanizmat institucionalë, për të siguruar tri dimensione:

- Për të siguruar të dhëna të pa qasshme;
- Për të konfirmuar (validuar) të dhënat, si dhe
- Për të marrë dhëna që lidhen me procese vjetore të brendshme.

Nëpërmjet pyetësorëve do të harmonizohet marrja e të dhënave bazuar në proceset kryesore vjetore institucionale, duke përfshirë kalendarin kyç të proceseve që ndërlidhen me monitorim dhe raportim.

Monitoruesit do të kenë pyetje të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar:

- Të strukturuar për të dhënat që kërkojnë informacion/konfirmim; dhe
- Gjysmë të strukturuar për të dhënat që kërkojnë ndërlidhje apo procese brenda komunale apo ndër-institucionale.



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +381 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com